

Implemented by:



Vendosja e mbrojtjes së konsumatorëve të karburanteve në kontekst: Politikë sektoriale me efekte të shumëfishta ekonomike për konsumatorët

€ Huluntim Politikash €



Vendosja e mbrojtjes së konsumatorëve të karburanteve në kontekst: Politikë sektoriale me efekte të shumëfishta ekonomike për konsumatorët



Instituti për Politika Zhvillimore – INDEP

Botim i Institutit për Politika Zhvillimore (INDEP) mbështetur nga EU. Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Asnjë pjesë e këtij botimi nuk guxon të riprodhohet, të ruhet në ndonjë sistem të të dhënave apo të transmetohet, në asnjë formë apo mënyrë, pa pëlqim paraprak nga botuesi. Botimi mund të shpërndahet në formë elektronike, por vetëm në tërësi dhe vetëm për qëllime jokomerciale.

Mbështetur nga:



Përmbajtja e këtij dokumenti, duke përfshirë opinionet e shprehura, jo domosdoshmërisht reflektojnë ato të donatorëve të INDEP, stafit të tyre, bashkëpunëtorëve apo Bordit.

Shënim:

Ky punim është shkruar në gjuhën angleze fillimisht. Prandaj, për arsye teknike, disa nga pjesët e tij kanë mbetur në origjinal, të papërkthyer.

Table of Contents

1. Hyrje në mbrojtjen e konsumatorit dhe të drejtat e konsumatorëve rreth karburanteve ..	2
2. Karakteristikat kryesore legjislative dhe institucionale të sistemit të cilësisë së karburanteve në Kosovë	4
2.1 Kuadri ligjor dhe institucional që siguron cilësinë e karburanteve dhe të drejtat e konsumatorëve	5
2.2 Sfidat nga perspektiva e konsumatorëve të karburanteve: Problemet strukturore të një sektori me performancë të dobët	7
3. Rastet e suksesshme të mbrojtjes së konsumatorëve të karburanteve: Sistemet e SH.B.A., BE dhe Japonisë për sigurimin e cilësisë së karburanteve	11
3.1 Metoda e përzier e SHBA-ve për të zbatuar Regjimin e Cilësisë së Karburanteve: Drejt ekonomisë më të madhe të karburanteve dhe tregjeve eko-miqësore të karburanteve.....	11
3.2 Kuadri rregullator i BE-së për tregjet e karburanteve: Rritja e transparencës dhe zgjedhjes për konsumatorët e karburanteve	17
3.3 Sistemi japonez i centralizuar i cilësisë së karburantit	23
Sistemi i kontrollit të cilësisë, zbatimit dhe pajtueshmërisë	23
3 Përfundimi	27
4 Rekomandime	29
5 Shtojcë.....	31

1. Hyrje në mbrojtjen e konsumatorit dhe të drejtat e konsumatorëve rreth karburanteve

Mbrojtja e konsumatorit është set politikash transversale që përfshin një gamë të gjerë të politikave sektoriale siç janë: siguria e produkteve, shërbimet bankare, energjia, etiketimi i produkteve, transporti dhe tregjet dixhitale. Mbrojtja e konsumatorit përbën një nga fushat më të rëndësishme për ndërhyrjen e politikave në botën e zhvilluar pasi shpenzimet e familjeve arrijnë në më shumë se 50% të BPV-së së vendeve më të zhvilluara.¹ Në këtë kontekst, mbrojtja e të drejtave të konsumatorit nuk synon vetëm mbrojtjen e qytetarëve nga produktet e pasigurta dhe aktivitetet e padrejta tregtare, por më tepër përdoret për të rritur besimin në tregje, për të nxitur konkurrencën dhe për të rritur rritjen ekonomike. Nga ana tjetër, kjo e justifikon zhvillimin e rregullave dhe praktikave të fuqishme të cilat sigurojnë një nivel të lartë të mbrojtjes së konsumatorit, duke u mundësuar qytetarëve të marrin vendime të mirëinformuara, të rrisin mirëqenien e tyre dhe të avancojnë interesat e tyre ekonomike.²

Revolucioni dixhital dhe bumi teknologjik i kanë bërë kufijtë të panevojshëm, duke rritur në mënyrë eksponenciale zgjedhjet e konsumatorëve pasi tregjet e botës janë bërë praktikisht të arritshme edhe në vendet më të largëta të botës, por gjithashtu edhe duke i ekspozuar konsumatorët ndaj rreziqeve më të mëdha, si biznese dhe praktika tregtare mashtruese, produkte të pasigurta, shkelje të privatësisë dhe mekanizmat joreagues dëmshpërblimi. Edhe pse rëndësia e të drejtave të konsumatorit ka qenë në fokus të politikave kohët e fundit, rregulloret që synojnë avancimin e të drejtave të konsumatorit janë miratuar dekada më parë. Në nivelin ndërkombëtar, njohja zyrtare e të drejtave të konsumatorit u bë në vitin 1985 kur Asambleja e Përgjithshme e KB miratoi unanimisht Udhëzimin e parë për Mbrojtjen e Konsumatorit, i cili ende qëndron si vija fundore për të drejtat e konsumatorit në të gjithë botën. Vendet tjera kanë ndjekur dhe zhvilluar më tej këto udhëzime dhe kanë vendosur rregulla strikte dhe mekanizma monitorimi për të siguruar që çekuilibrat e tregut të mos ndikojnë negativisht në anën e kërkesës, të përfaqësuar nga konsumatorët. Regjimet e sotme rregullatore mbi të drejtat e konsumatorit theksojnë rolin e konsumatorëve si agjentë të ndryshimit, veçanërisht në lidhje me

¹ Në Bashkimin Evropian, shpenzimet e konsumatorëve përbëjnë më shumë se 52% të PBV-së së tij. Në SH.B.A., shpenzimet e konsumatorit zënë 66% të PBV-së së saj. Ngjashëm edhe në Japoni, shpenzimet e konsumatorit zënë mbi 54% të PBBV-së së vet. Për më shumë detaje, ju lutem shikoni: <https://www.ceicdata.com/en/indicator/kosovo/private-consumption--of-nominal-gdp#:~:text=Kosovo's%20Private%20Consumption%20accounted%20for,an%20average%20share%20of%2088.1%20%25.>

² Për më shumë informata rreth rolit të Mbrojtjes së Konsumatorit mbi treguesit ekonomikë, ju lutem shikoni: [https://www.europarl.europa.eu/RegData/etudes/STUD/2019/638396/IPOL_STU\(2019\)638396_EN.pdf](https://www.europarl.europa.eu/RegData/etudes/STUD/2019/638396/IPOL_STU(2019)638396_EN.pdf)

konsumin e qëndrueshëm dhe Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm (OZhQ).³ Për të akomoduar këtë rol thelbësor të konsumatorëve në ekonominë e tregut, vendet e zhvilluara kanë miratuar rregulla për garantimin e sigurisë së produktit, rritjen e njohurive të konsumatorëve për tregjet, krijimin e mekanizmave efikas të korigjimit dhe zgjerimin e zgjedhjeve të konsumatorëve.

Duke qenë që mbrojtja e konsumatorit është set politikash horizontale, rregullat dhe parimet e saj zhvillohen dhe funksionalizohen më tej në politikat kryesore sektoriale, me synimin për të fuqizuar pozitën e konsumatorit në transaksione specifike ekonomike dhe për të siguruar tregje të qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse. Tregjet e karburanteve përfaqësojnë një treg shumë specifik që për shkak të karakteristikave të tij, kryesisht joelastikësisë dhe ndikimit të rëndësishëm në mjedis, rregullohen në mënyrë rigoroze dhe standardet e imponuara mbikëqyren shumë. Tregu i derivateve të karburanteve është aktivitet konsiderueshëm fitimprurës i biznesit dhe ka efekte të konsiderueshme në sektorë të rëndësishëm të ekonomisë, si transporti, industria, bujqësia dhe ngrohja. Duke pranuar këtë efekt zinxhir të tregjeve të karburanteve në ekonomi, vendet e zhvilluara kanë miratuar rregulla dhe kanë vendosur një program të qëndrueshëm të pajtueshmërisë për të siguruar mbrojtjen e duhur të konsumatorëve të karburanteve, por edhe funksionimin e mirë të tregjeve të brendshme. Shtetet e Bashkuara kanë qenë ndër të parët që miratuan akte specifike që rregullojnë cilësinë e karburanteve (1970) dhe kufizojnë përmbajtjen e substancave të dëmshme në karburante. Ngjashëm, edhe BE ka miratuar akte të njëpasnjëshme mbi kufijtë e lejueshëm të sulfurit, benzenit dhe plumbit (1976 dhe 1981) në naftë dhe benzinë. Këta shembuj pastaj u ndoqën edhe nga vendet e tjera të zhvilluara (Japonia, Koreja e Jugut, Kanada), dhe cilësia e karburanteve është integruar në agjendën e zhvillimit nën përparësinë e mbrojtjes së konsumatorit dhe mjedisit.

Në këtë kontekst ndërkombëtar, Kosova nën administrimin e UNMIK-ut ka miratuar Ligjin e saj të parë për Mbrojtjen e Konsumatorit (Ligji 2004/17) dhe Ligjin për Tregtinë e Naftës dhe Produkteve të Naftës në Kosovë. Këto akte janë ndryshuar pas pavarësisë së Kosovës dhe legjislacioni dytësor është miratuar për të mbështetur zbatimin e ligjeve. Pas pavarësisë së Kosovës, zhvillimet legjislative në lidhje me mbrojtjen e konsumatorit në përgjithësi, janë ndikuar jashtëzakonisht shumë nga procesi i integritimit evropian, pasi institucionet i kanë dhanë përparësi përafërimit të kornizës legjislative me legjislacionin e BE-së dhe praktikat më të mira.

³ Për më shumë detaje mbi rolin e konsumatorit në konsumin e qëndrueshëm dhe OZhQ-të, ju lutem shikoni: https://ec.europa.eu/commission/sites/beta-political/files/consumer_agenda_2012_en.pdf dhe <http://www.tudelf.org.tr/pdf/un-guidelines-for-consumer-protection-2016.pdf>

Në vijim, ky punim do të paraqesë kornizën ekzistuese institucionale dhe legjislative në Kosovë për të drejtat e konsumatorëve të karburanteve, si dhe sfidat që i pengojnë konsumatorët e karburanteve të Kosovës të kërkojnë të drejtat e tyre ekonomike të garantuara me ligj. Tutje, punimi vazhdon me paraqitjen e rasteve të suksesshme të SHBA, BE dhe Japoni në garantimin e të drejtave të konsumatorëve të karburanteve. Çdo seksion ofron karakteristikat kryesore të praktikave të mbrojtjes së konsumatorëve të karburantëve dhe ndikimin që ka pasur zbatimi i rregullave të karburanteve në avancimin e interesave ekonomike të konsumatorëve.⁴ Në seksionin e fundit, bazuar në sfidat e identifikuar, por edhe praktikën më të mira të huaja, punimi ofron një listë të rekomandimeve me hapa konkret për t'u përfshirë në ligjet e Kosovës nga politikëbërësit dhe praktikuesit e ligjit.


2. Karakteristikat kryesore legjislative dhe institucionale të sistemit të cilësisë së karburanteve në Kosovë

Kosova nuk ka rezerva natyrore të naftës apo rafineri për përpunimin e produkteve të naftës prandaj kërkesat e saj të brendshme mbulohen ekskluzivisht nga importet e huaja. Siç tregon figura më poshtë, importi i produktit të naftës bruto ka qenë në rritje të vazhdueshme në vitet e fundit, duke i shndërruar produktet e naftës në produktet kryesore të importuara në Kosovë.⁵ Si një biznes fitimprurës me rritje të kërkesës së brendshme, tregu i karburanteve përfaqëson një nga sektorët më të rëndësishëm për konsumatorët, si në drejtim të të pasurit karburant të sigurt dhe cilësor për automjetet e tyre, por edhe për një mjedis të shëndetshëm. Prandaj, të drejtat e konsumatorit të karburanteve përfaqësojnë një sektor shumë të rëndësishëm për ndërhyrjen në politika, i cili do të garantonte një sistem efikas që i përgjigjet nevojave dhe kërkesave të konsumatorëve të karburanteve.

⁴ Përveç rregulloreve të cilësisë së karburantit, punimi përfshin në analizë edhe akte të tjera legjislative që rregullojnë tregjet e automobilave. Në mënyrë të veçantë, vëmendja i kushtohet Ekonomisë së Karburantit dhe Rregulloreve të reduktuara CO2 sepse zbatimi i tyre është i lidhur ngushtë me dispozitat e cilësisë së karburantit dhe ato synojnë të njëjtën kategori të konsumatorëve (konsumatorët e automjeteve dhe karburanteve).

⁵ Për më shumë detaje mbi statistikën e tregtisë ndërkombëtare për Kosovën, <https://ask.rks-gov.net/media/5602/external-trade-2019.pdf>

Figura 1: Importi i karburanteve në Kosovë⁶



2.1 Kuadri ligjor dhe institucional që siguron cilësinë e karburanteve dhe të drejtat e konsumatorëve

Dokumenti i parë strategjik që iu jep përparësi tregjeve të karburanteve, sigurisë dhe cilësisë së karburanteve në veçanti, është Strategjia e Zhvillimit të Karburanteve të Lëngshme, e cila është miratuar në vitin 2003 nën administrimin e UNMIK. Strategjia pranon faktin që Kosova është plotësisht e varur nga importi i lëndëve djegëse të lëngshme dhe i nxit institucionet të marrin masa konkrete për të rritur efikasitetin e karburanteve dhe për të zvogëluar efektet e dëmshme të karburanteve për mjedisin.⁷ Ky dokument hapi rrugën drejt miratimit të aktit të parë legjislativ për këtë çështje dhe nënvizon domosdoshmërinë e përafritit të dispozitave ligjore me rregulloret e BE-së në lidhje me transportin, shpërndarjen dhe tregtimin e produkteve të naftës (shih Shtojcën).

Strategjia çoi në miratimin e Ligjit të parë mbi tregtinë e naftës dhe produkteve të naftës në Kosovë. Ligji, i cili u ndryshua më vonë në 2008 dhe 2009, përcakton standardet në zvogëlimin e përmbajtjes së substancave toksike në karburante (maksimumi 0.2% sulfur dhe 0.15% plumb) dhe kërkon nga operatorët e karburanteve të mbajnë rezerva strategjike në rast të krizës së furnizimit me naftë ose

⁶ Vjetari Statistikor i Republikës së Kosovës për vitin 2018, <https://ask.rks-gov.net/en/kosovo-agency-of-statistics/add-news/statistical-yearbook-2018>

⁷Për më shumë detaje, shikoni: <https://www.esiweb.org/pdf/bridges/kosovo/10/12.pdf>

emergjencave natyrore. Gjithashtu, përmes këtij ligji u themelua Këshilli për Licencimin e Operatorëve të Karburanteve dhe janë vendosur procedurat dhe kriteret minimale për dhënien e licencës për transportimin, magazinimin dhe shitjen e produkteve të naftës. Në lidhje me mbrojtjen e konsumatorit të karburanteve, ligji kërkon që operatorët ekonomikë të përmbahen nga aktivitetet mashtruese që do të mashtronin blerësin mesatar, veçanërisht në lidhje me emrin e markës, çmimin dhe sasinë e produkteve të naftës. Operatorët ekonomikë të gjetur në aktivitete mashtruese sanksionohen me heqjen e licencës (sanksioni i vetëm i përcaktuar në ligjin fillestar). Ky ligj është ende në fuqi, dhe megjithëse u ndryshua në 2008 dhe 2009, vetëm ndryshime të vogla (veçanërisht në futjen e gjobave për shkelësit e ligjit) u futën dhe që nga ajo kohë, asnjë ndryshim i ligjit nuk është bërë. Kështu, Ligji ekzistues është i vjetëruar, jokritik në adresimin e çështjeve kryesore në lidhje me cilësinë e karburanteve dhe të drejtat e konsumatorëve dhe ka mbetur prapa në akomodimin e standardeve ndërkombëtare, të cilat janë gjithnjë në zhvillim, të cilësisë së karburanteve.

Legjislacioni sekondar që rrjedh nga Ligji përbëhet nga disa akte dhe është ndryshuar disa herë. Udhëzimet administrative më të rëndësishme janë: Udhëzimi Administrativ Nr. 06/2019 për kërkesat teknike për importin, magazinimin, shitjen me shumicë dhe pakicë të karburanteve të naftës dhe depozitave të pastrimit; Udhëzimi Administrativ Nr. 07/2018 për përcaktimin e procedurave të licencimit për subjektet që merren me aktivitete të sektorit të naftës (dhe ndryshimet pasuese të tij); dhe Udhëzimi Administrativ Nr. 07/2012 për Cilësinë e Lëndëve Djegëse të Lëngshme të Naftës. Dy UA-të e para përcaktojnë kriteret në lidhje me kushtet e ruajtjes së karburanteve (licenca të ndara për produktet e naftës të importuara), ndërsa UA mbi Cilësinë e Lëndëve të Djegshme të Naftës është i rëndësishëm pasi ai përcakton vlerat e lejueshme të përbërësve dhe treguesit e cilësisë së naftës-produktet e prejardhura. Më e rëndësishmja, përcakton metodën e testimit, mbikëqyrjes dhe monitorimit të naftës cilësore. Gjithashtu, përcakton më tej procedurat e konformitetit dhe vlerësimin e përgjithshëm të cilësisë. Sidoqoftë, këto UA janë të pamjaftueshme për të garantuar një sistem efikas të sigurimit të cilësisë dhe për të siguruar një ndarje të qartë të përgjegjësive midis institucioneve të përfshira.

Në *nivelin institucional*, Ligji për Produktet e Naftës cakton përgjegjësinë për sigurimin dhe monitorimin e cilësisë së karburanteve në Doganat e Kosovës dhe Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë. Dogana e Kosovës është përgjegjëse për të kontrolluar dhe monitoruar cilësinë e karburanteve të importuara, ndërsa Ministria e Tregtisë dhe Industrisë (DAMMrtamenti për Rregullimin e Tregut të Naftës dhe Inspektoratit të Tregut) ka të drejtë të zhvillojë politika dhe të sigurojë cilësinë e karburanteve në

tregun e brendshëm.⁸ DAMMrtamenti për Rregullimin e Tregut të Naftës është kryesisht përgjegjës për licencimin e operatorëve ekonomikë, përgatitjen e raporteve statistikore për rastet e mosrespektimit dhe mbajtjen e regjistrit të subjekteve shkelëse. Nga ana tjetër, Inspektorati i Tregut kryen vizita në terren, mbledh shembuj dhe sanksionon operatorët që shkelin dispozitat ligjore. Siç paraqitet në seksionin tjetër, këto struktura institucionale janë shumë të kufizuara në ushtrimin e përgjegjësiave të tyre ligjore për shkak të problemeve strukturore siç janë: paaftësia institucionale dhe logjistike për të kryer kontrole të duhura të cilësisë, mungesa e koordinimit ndërmjet institucioneve të zbatimit të ligjit, dhe mungesa e statistikave dhe mekanizmave të monitorimit.

Në *nivelin strategjik*, Kosova nuk ka një strategji ose metodologji specifike për sigurimin e cilësisë së karburanteve. Programi për Mbrojtjen e Konsumatorit 2016-2020 ka paraparë 4 masa për sektorin e karburanteve, ku të gjithat lidhen me zbatimin e legjislacionit, por pa masa specifike ose tregues mbi zbatimin. Nga ana tjetër, Raportet e Komisionit të BE-së për Kosovën në mënyrë të përsëritur u kanë kërkuar institucioneve të Kosovës të hartojnë dhe miratojnë një Ligj të ri mbi Tregtinë e Produkteve të Naftës dhe të marrin të gjitha masat e nevojshme për të zhvilluar kushtet për infrastrukturën alternative të karburanteve. Shtuar, edhe Programi Kombëtar për Zbatimin e MSA-së ka propozuar për 2 vjet me radhë miratimin e Ligjit të ri për produktet e naftës, por deri më tani nuk është bërë asnjë përparim.

2.2 Sfidat nga perspektiva e konsumatorëve të karburanteve:

Problemet strukturore të një sektori me performancë të dobët

Në vitin 2019, Zyra Kombëtare e Auditimit e Kosovës ka publikuar një raport gjithëpërfshirës të auditimit të performancës mbi Cilësinë e Karburanteve dhe Sistemin e Monitorimit. Pas një auditimi të detajuar të segmenteve kryesore të sigurimit të cilësisë, raporti përfundon si në vijim:


- Sistemi ekzistues i kontrollit dhe monitorimit të cilësisë së karburanteve nuk është në gjendje të sigurojë cilësinë e karburanteve të importuara dhe karburanteve të shitura në tregun e brendshëm dhe është gati të *kollapsojë*.

⁸ Ka edhe struktura të tjera brenda MTI-së që janë të rëndësishme për dispozitat e cilësisë së karburanteve. Drejtoria e Akreditimit të Kosovës, Agjencia e Metrologjisë dhe Departamenti për Mbrojtjen e Konsumatorit.

- Kontrollat e karburanteve të importuara të kryera nga Dogana e Kosovës nuk janë të duhura, sistematike dhe nuk kanë arritur të garantojnë që karburantet e importuara në Kosovë përmbushin standardet e brendshme dhe Evropiane për cilësinë e karburanteve.
- Mekanizmat e testimit, monitorimit dhe inspektimit janë të dobëta dhe si rezultat nuk janë në gjendje të ndalojnë qarkullimin e lëndëve djegëse me cilësi të ulët në tregun e brendshëm. Funksionimi i paautorizuar i organeve të inspektimit, numri minimal i standardeve dhe parametrave të testuar, si dhe asnjë mekanizëm për tërheqjen e lëndëve djegëse me cilësi të ulët nga pikat e shitjes po e bëjnë Kosovën një treg tërheqës për lëndë djegëse me cilësi të ulët.
- Mungesa e statistikave themelore dhe regjistrimit për subjektet shkelëse dhe mungesa e një metodologjie të bazuar në rrezik për inspektimet ka rezultuar në masa ndëshkimore joefikase për subjektet jo-konform.
- DAMMrtamenti për Mbrojtjen e Konsumatorit është dëshmuar joefikas në sigurimin e një mekanizmi të duhur të dëmshpërblimit për konsumatorët që kanë përjetuar humbje financiare për shkak të lëndëve djegëse me cilësi të ulët.

Shifrat më poshtë janë përgatitur nga Zyra Kombëtare e Auditimit dhe tregojnë mangësitë kryesore të sistemit të cilësisë së karburanteve në Kosovë.


Figura 2: Numri i rasteve që nuk kanë raporte laboratorike në sistemin doganor⁹



⁹ Zyra Kombëtare e Auditimit e Kosovës, Sistemi i Kontrollit dhe Monitorimit të Cilësisë së Karburanteve, 2019, http://www.zka-rks.org/wp-content/uploads/2019/11/Sistemi-i-kontrollit-dhe-monitorimit-te-cil%C3%ABsis%C3%AB-se-derivateve_Eng.pdf

Sipas grafikut të treguar më sipër, gjatë vitit 2018 (janar-dhjetor), 19% e mostrave të ekzaminuara nuk janë testuar, por janë paraqitur bashkë me raporte të karburanteve të tjerë të testuar. Ndërsa, në 5% të mostrave raporti i testimit si dokument i bashkangjitur në sistem ka munguar, megjithëse një dokument i tillë ka ekzistuar dhe është dorëzuar në forma të tjera. Gjatë muajve maj-dhjetor 2017, në 20% të mostrave, raportet e karburanteve të tjera të testuar më parë janë paraqitur pa u testuar vetë karburanti, dhe në 20% ka munguar raporti i testimit të mostrave si dokument i bashkangjitur në sistem, megjithëse këto lëndë djegëse janë testuar. Gjatë janarit-marsit 2019, nuk ka pasur asnjë rast të identifikuar të mungesës së raporteve të testimit në sistem.

Figura 3: Krahasim i parametrave të testuar siç kërkohet nga Udhëzimi Administrativ 01/2017 dhe siç kryhet nga Dogana ¹⁰



¹⁰ Zyra Kombëtare e Auditimit e Kosovës, Sistemi i Kontrollit dhe Monitorimit të Cilësisë së Karburanteve, 2019 http://www.zka-rks.org/wp-content/uploads/2019/11/Sistemi-i-kontrollit-dhe-monitorimit-te-cil%C3%ABsis%C3%AB-se-derivateve_Eng.pdf

Numri i parametrave të testuara nga Dogana është shumë i ulët për të përcaktuar në mënyrë të besueshme cilësinë e karburanteve. Testimi i vetëm një numri të vogël të parametrave është provë që laboratorit nuk i ka pajisjet e nevojshme për të testuar të gjitha parametrat. Hendeku midis parametrave të kërkuar nga UA dhe numrit të parametrave të testuar nga Dogana i bën këto teste të mangëta për të garantuar siguri për cilësinë e karburanteve në import.

Çmimi për këto probleme kronike dhe strukturore në sigurimin e një sistemi të duhur dhe funksional të cilësisë së karburanteve paguhet nga konsumatorët kosovarë të cilët përballen me pak mundësi në treg dhe nuk kanë zgjidhje tjetër përveç se të blejnë karburante me cilësi të ulët, duke u shkaktuar atyre humbje të shumta, disa prej të cilave janë të renditura si në vijim:

- Performanca e automjeteve dëmtohet rëndë nga karburantet me cilësi të ulët, duke rezultuar në kosto shtesë për mirëmbajtjen e automjeteve të cilat përndryshe nuk do të ndodhnin (nëse karburantet do të ndiqnin standardet ndërkombëtare);
- Kostot që lidhen me problemet shëndetësore të shkaktuara nga ndotja e ajrit dhe emetimi i substancave toksike nga përbërësit në karburante, që tejkalojnë parametrat normalë;
- Kosto shtesë për shkak të ekonomisë së ulët të karburanteve që rezulton në Kilometër më të ulët për Litër;
- Kostoja e krijuar nga mospërputhja mes cilësisë së karburanteve siç është deklaruar nga operatorët ekonomikë dhe produktit aktual të shitur në treg;
- Kostoja e shkaktuar nga tregu i mbyllur i karburanteve që ofron më pak mundësi për konsumatorët, kryesisht për shkak të hendekut legjislativ në lejimin e tregjeve të reja për biokarburantet dhe infrastrukturën alternative të karburanteve (më shumë mundësi – çmime më të ulëta).

3. Rastet e suksesshme të mbrojtjes së konsumatorëve të karburanteve: Sistemet e SH.B.A., BE dhe Japonisë për sigurimin e cilësisë së karburanteve

3.1 Metoda e përzier e SHBA-ve për të zbatuar Regjimin e Cilësisë së Karburanteve: Drejt ekonomisë më të madhe të karburanteve dhe tregjeve eko-miqësore të karburanteve

Modeli i Shteteve të Bashkuara për sigurimin e cilësisë së karburanteve është sistem kontrolli dhe monitorimi i të gjithë zinxhirit të shpërndarjes së karburanteve, nga përpunuesit e karburanteve e te transportuesit dhe shitësit me pakicë. Modeli miraton një program të përzier inspektimi i cili drejtohet dhe financohet nga Agjencia e Mbrojtjes së Mjedisit (AMM), por mbështetet gjithashtu nga sigurimet vullnetare të cilësisë të drejtuara nga konsorciumet e industrive.¹¹ AMM është organi publik përgjegjës për azhurnimin dhe monitorimin e programit të pajtueshmërisë, i cili përfshin regjistrimin e karburanteve, testimin e cilësisë, inspektimin dhe vendosjen e ndëshkimeve që shkelin. Aktet kryesore që rregullojnë autoritetin e AMM në sigurimin e pajtueshmërisë së karburanteve janë Akti i Ajrit të Pastër i Sh.B.A., Rregullorja për emetimet e gazrave serë (GHG), Rregullorja për smog, blozë dhe ndotje të tjera të ajrit nga makinat dhe kamionët, Rregulloret për Ekonominë Mesatare të Karburanteve të Korporatave.¹² Sa i përket çmimeve të karburanteve, Komisioni Federal i Tregtisë është autoriteti përgjegjës për të mbrojtur të drejtat e konsumatorëve mbi çmimet e karburanteve, por gjithashtu për të monitoruar dhe adresuar sjelljen anti-konkurruese dhe aktivitetet e padrejta tregtare në sektorin e karburanteve.

Në zbatim, programi i përputhshmërisë së AMM-së vendos përgjegjësinë për teste kryesisht te rafinuesit dhe importuesit e karburanteve të cilët duhet të provojnë pajtueshmërinë përmes regjistrimit, analizës së karburanteve dhe raportimit. AMM provon saktësinë e raportimit duke autorizuar marrjen e mostrave dhe testeve laboratorike të pavarura, duke ndërmarrë kontrolle të planifikuara dhe të

¹¹ Për më shumë detaje mbi elementët kryesorë të programit të sigurimit të cilësisë së karburanteve në SH.B.A., shikoni: https://theicct.org/sites/default/files/publications/ICCT_fuelqualityBP_nov2011.pdf

¹² Për më shumë detaje, shikoni: <https://www.epa.gov/regulations-emissions-vehicles-and-engines>

rastit në rafineri, pajisje importi, terminale ngarkimi dhe qendra të shitjes me pakicë. Përveç testimi të cilësisë së karburanteve nga rafinuesit ose importuesit, AMM përdor edhe dy metoda shtesë për të siguruar testimin e cilësisë së karburanteve: a) industrinë paguajnë laboratorë të pavarur për të vlerësuar cilësinë e produkteve të tyre, të cilat më pas dorëzohen në AMM dhe në rafineri ose importues të dyshuar jo-konform, por edhe në laboratorë të pavarur për të siguruar që vlerësimet e laboratorëve janë të besueshme dhe të paanshme. Gjithashtu, sistemi në vend miraton të ashtuquajturën 'përgjegjësi të supozuar' e cila mban përgjegjëse për gjambat palën e cila është gjetur duke shitur karburant që tejkalon kufijtë e benzenit, sulfurit ose substancave të tjera toksike. Kjo inkurajon të gjitha palët të marrin masa për të zbatuar sigurimin e cilësisë në rrjedhën e poshtme përgjatë zinxhirit të shpërndarjes, duke rezultuar në mekanizma shtesë kontrolli që sigurojnë cilësinë e karburanteve.

Dënimet e Aktit të Ajrit të Pastër në rast të mosrespektimit parashikojnë ndëshkime administrative deri në \$37,500 në ditë, plus shumën e supozuar të kursimeve ose përfitimeve ekonomike që mund të kenë rezultuar nga shkelje të tilla. Kjo nuk është shumë fikse, por më tepër një llogaritje e bazuar në faktorë të ndryshëm siç janë të ardhurat dhe madhësia e biznesit, përfitimet ekonomike të fituara përmes shkeljes së standardeve dhe seriozitetin e shkeljes së standardeve. Dënimet nuk janë të kufizuara vetëm për rafinuesit ose importuesit / shitësit me pakicë që shesin karburante që nuk i plotësojnë standardet e kërkuara, por edhe për laboratorë të pavarur të cilët paraqesin deklarata false në AMM për cilësinë e karburanteve të rafinerëve dhe / ose shitësve. Në mënyrë që të rritet pajtueshmëria, AMM përdor programin Mesatarizimi, Bankat dhe Tregtimi i cili lejon fleksibilitet për përpunuesit të përmbushin standardet gjatë periudhës së pajtueshmërisë. Për shembull, nëse një rafineri përputhet tepër me standardet e sulfurit për një periudhë të caktuar kohe; ajo rafineri fiton kredi bankare të cilat mund t'i përdorë në një kohë kur është e pamundur të operohet pa rritur emetimet e sulfurit pak mbi standardet.¹³

Përfitimet ekonomike të konsumatorëve amerikanë të karburanteve duke zbatuar cilësinë e karburanteve dhe emetimet e GES përfshijnë por nuk kufizohen në:

- Automjete janë 98-99% më të pastra për shumicën e ndotësve të ajrit krahasuar me vitet 1960 (shih figurën 4);

¹³ Për më shumë detaje mbi Mesatarizimin, Bankat dhe Tregtinë (MBT), shikoni: <https://www.law.cornell.edu/cfr/text/49/535.7> <https://www.law.cornell.edu/cfr/text/49/535.7>

- Rritje e ndjeshme e Ekonomisë së Karburanteve (milje për galon) dhe ulje e emetimeve të CO2 (shih figurën 5)
- Qytetet kryesore të SHBA-së kanë përmirësuar cilësinë e ajrit, në kushtet e rritjes së popullsisë dhe miljeve të automjeteve të udhëtuara, duke rezultuar në përmirësimin e shëndetit dhe uljen e shpenzimeve për sëmundjet e lidhura me ndotjen e ajrit (shih figurën 4 dhe figurën 6)
- U inkurajua inovacioni i teknologjisë në prodhimin e automjeteve më të pastra dhe më të lira¹⁴
- Rritje e fuqisë ekonomike të blerësve të makinave (vendim i informuar) përmes rritjes së informacionit në lidhje me ekonominë e karburanteve, kostot e karburanteve dhe ndikimin mjedisor të automjeteve (shih figurën 7)
- Rritje e konsiderueshme e kursimeve neto të konsumatorit nga pajtueshmëria me standardet CAFE (shih figurën 8).

Figura 4: Krabasimi i zonave të rritjes, ulja e emisioneve dhe rritja e ekonomisë së karburanteve ¹⁵





Figura tregon ulje të mprehtë të emisioneve agregate të gjashtë ndotësve më të zakonshëm të ajrit dhe uljen e qëndrueshme të emetimeve të CO2, në kushtet e rritjes së konsiderueshme të përdorimit të

¹⁴ Për më shumë info, shikoni: <https://www.AMM.gov/clean-air-act-overview/clean-air-act-and-economy#technology>

¹⁵ Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, shikoni: <https://www.epa.gov/automotive-trends/highlights-automotive-trends-report>

automjeteve (milje të udhëtuara) dhe rritjes së vazhdueshme të popullsisë. Kjo tregon një rritje të dukshme të efikasitetit të karburanteve si në aspektin e ndikimit në mjedis dhe ekonomisë së karburanteve (milje të rritura për gallon). Rritja e ndjeshme e produktit të brendshëm bruto tregon korrelacionin e supozuar midis cilësisë së karburanteve / standardeve të gazrave serrë dhe rritjes ekonomike.

Figura 5: Emetimet e vlerësuara të CO2 dhe Ekonomia e Karburanteve ¹⁶




Të dhënat në figurë tregojnë rritje të jashtëzakonshme të Ekonomisë së Karburanteve në terma të miljeve për liter (MPG) dhe uljen përkatëse të emetimeve të CO2. Siç tregojnë trendet, ekziston një lidhje e ngushtë midis rritjes së MPG dhe uljes së emetimeve të CO2 (shih të dhënat në 2005), duke provuar se cilësia e karburanteve nuk ndikon vetëm në mjedis (përkatësisht në shëndet), por gjithashtu kontribuon drejtpërdrejt në kosto-efikasitetin e automjeteve të makinave.¹⁷

¹⁶ Ibid

¹⁷ Për raportin e plotë mbi trendet e automobilave (2019), shikoni: <https://nepis.epa.gov/Exe/ZyPDF.cgi?Dockey=P100YVK3.pdf>

Figura 6: Kostot dhe përfitimet e standardeve të cilësisë së karburanteve¹⁸



Grafiku tregon koston e zbatimit të standardeve të cilësisë dhe përfitimeve të fituara në formën e mirëqenies ekonomike dhe kursimeve në shpenzimet mjekësore për sëmundjet shëndetësore të lidhura me ndotjen e ajrit.

Figura 7: Etiketa e Ekonomisë së Karburanteve bashkangjitur automjeteve në SH.B.A.¹⁹




¹⁸ Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Shteteve të Bashkuara, <https://www.epa.gov/clean-air-act-overview/clean-air-act-and-economy#technology>

¹⁹ Ibid, <https://www.epa.gov/greenvehicles/learn-about-fuel-economy-label>

Kjo etiketë është e detyrueshme në SH.B.A. për të gjithë shitësit e automjeteve. Etiketa është shumë informuese, duke i shpjeguar klientit performancën kryesore të automjetit që ndihmon konsumatorin të marrë vendime të mirëinformuara. Etiketa informon konsumatorin për Ekonominë e Karburanteve të automjetit, smogut dhe emetimet e gazrave serrë dhe më e rëndësishmja, ofron informacione për kostot vjetore të karburanteve dhe kursimet e gjeneruara nga blerja e një automjeti me performancat e deklaruar.

Figura 8: Kostot vjetore të pajtueshmërisë së makinës dhe kursimet e karburanteve për automjet²⁰



Shifra e mësipërme tregon përfitimet neto të blerjes së makinave që plotësojnë standardet CAFE. Duke supozuar se makinat janë blerë duke përdorur hua financiare, të dhënat në tabelë tregojnë se kursimet vjetore të karburanteve tejkalojnë koston vjetore. Pas vitit të gjashtë, kostot e ulëta të sigurimit dhe mirëmbajtjes vazhdojnë në çdo vit. Linjat në secilën tabelë tregojnë kursimet neto kumulative në intervalin e dhjetë viteve të para të funksionimit të automjetit.

²⁰ Synapse, Kursimet e Konsumatorit nga Standardet Mesatare të Ekonomisë së Karburanteve prej 2025 Korporatave (CAFE) <https://advocacy.consumerreports.org/wp-content/uploads/2016/05/Consumer-Savings-From-CAFE-2025.pdf>

3.2 Kuadri rregullator i BE-së për tregjet e karburanteve: Rritja e transparencës dhe zgjedhjes për konsumatorët e karburanteve

Në Agjendën Evropiane të Konsumatorit, të drejtat e konsumatorëve të karburanteve adresohen në sektorin e Udhëtimit dhe Transportit dhe përparësitë kryesore janë vendosur në lidhje me promovimin e të drejtave të konsumatorëve dhe rritjen e informacionit për të mbështetur zgjedhjen e konsumatorit mbi cilësinë e karburanteve, etiketimin e makinës, karburantet alternative dhe karburantet e transportit.²¹ Në kontekstin e rritjes së rëndësisë së miratimit të politikave që luftojnë ndryshimin e klimës, BE-ja i ka dhënë përparësi të drejtave të konsumatorëve të karburanteve në respektimin e interesit të tyre ekonomik si përdorues të karburanteve, por edhe në adresimin e shqetësimeve të tyre shëndetësore të shkaktuara nga ndotja e ajrit dhe degradimi natyror. Në këtë drejtim, regjimi rregullator ekzistues i BE-së është i justifikuar jo vetëm në adresimin e çmimeve, cilësisë, zgjedhjeve dhe dëmshpërblimeve të konsumatorëve në kuptimin ekonomik kufizues të avancimit të të drejtave të konsumatorëve, por më tepër konsideron interesat e konsumatorëve për të pasur një mjedis më të shëndetshëm dhe të qëndrueshëm.

Rregullat e BE-së për industrinë e karburanteve janë të konsoliduara në Direktiva dhe Rregullore të ndryshme. Më të rëndësishmet në adresimin e të drejtave të konsumatorëve të karburanteve janë renditur si më poshtë:

